



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/01-16500  
Dt: 28.10.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Rregullores QRK Nr.23/2023 Për Procedurat e Punës në Tryezat Multidisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit, me qëllim të themelimit të tryezës multidisiplinare me datë 28.10.2024, miraton këtë:

### V E N D I M

1. Themelohet tryeza Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit në këtë përbërje:

- Menaxheri i rastit nga Qendra përkatëse për Punë Sociale;
- Ndhimës menaxheri i rastit nga QPS;
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë të Viktimave - Mbrojtësi i Viktimave;
- Shërbimi Sprovues i Kosovës - Zyrtari i Shërbimit Sprovues;
- Qendra e Mjekësisë Familjare - mjekë specialistë sipas specifikave të rastit;
- Policia e Kosovës;
- Qendra për Shëndet Mendor - specialist i fushës për trajtimin e fëmijëve;
- Drejtoria Komunale për Arsim - Zyrtar për Arsim;
- Drejtoria Komunale për Mirëqenie Sociale - Zyrtari përgjegjës;
- Psikologu/Punëtori, Social/Pedagogu i Shkollës ose përfaqësues i deleguar nga institucioni edukativo-arsimor;
- Zyra Komunale për Komunitete - Zyrtari për Komunitet;
- Institucioni për Strehim Përkujdesës ose familja strehuese;
- Zyra Komunale për të Drejtat e Njeriut - Zyrtari për të Drejtat e Njeriut/Fëmijës;
- Përfaqësues të Organizatave Joqeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

1. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, Tryeza Multidisiplinare është nën udhëheqjen e menaxherit të rastit dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Trajton rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore në bazë të interesit më të mirë të fëmijës;
- Përcjell dhe në vazhdimësi rishqyrton vlerësimin e rastit të bërë paraprakisht nga menaxheri i rastit, duke e plotësuar me informata të përditësuara varësisht nga ndryshimi i gjendjes së fëmijës apo rrethanave në rast;
- Bashkërendon dhe zhvillon procesin e planifikimit të përbashkët të veprimit për mbrojtje të fëmijës në përputhje me rrethanat dhe me legjislacionin përkatës në fuqi;
- Koordinon ofrimin e shërbimeve për mbrojtje, rehabilitim, dhe integrim apo riintegrim të fëmijës, në mënyrë të qëndrueshme dhe përkrah familjet e tyre ose kujdestarin;
- Rishikon planin individual për mbrojtjen e fëmijës në baza mujore, në raste specifike edhe më shpesh;
- Harton raportin vjetor për punën e vet dhe raportin tek Komuna dhe sipas kërkesës edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit për të Drejtat e Fëmijës;
- Tryeza Multidisiplinare mbyll rastin kur vlerësohet se të gjitha shërbimet e nevojshme janë ofruar dhe është ulur niveli i rrezikut apo nuk ka rrezik për mirëqenien e fëmijës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi i'u dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit të Komunës;
- Qendrës për Punë Sociale;
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Arkivit.

  
**Ardian Gjini**  
**Kryetari i Komunës së Gjakovës**